



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 37 Prot.

Tiranë, më datë 21.01 .2022

VENDIM
Nr. 9, datë 20.01.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.01.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin e restaurimit “Projekt restaurimi për Banesën e Alush Takes, Konispol”, pasuri kulturore “monument kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues z. Dritan Papavasili, projektues të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore z. Genci Samimi dhe zhvillues Z. Dhimitër Tola:
 - Në fasadën kryesore ku propozohet të bëhet risuvatimi, të bëhet diferencimi i fazave të ndërtimit të objektit;
 - Të rishikohet ndërhyrja në pjesën e murit rrethues të objektit, portës hyrëse dhe rrënojave brenda kufirit të pronës;
 - Të unifikohen materialet e përdorura në strukturat e propozuara për t’u ndërtuar në oborrin e banesës.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

